

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

**11.05.2023
Ora 12:11**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave të Misionit të Vëzhgimit të OSBE/ODIHR, të Institutit Demokratik Amerikan, Parlamentit European dhe Ambasadave Italiane, Amerikane, Sllovene, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëherë jemi me këtë rend dite në seancën e sotme. Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave të Misionit të Vëzhgimit të OSBE/ODIHR, të Institutit Demokratik Amerikan, Parlamentit European dhe Ambasadave Italiane, Amerikane, Sllovene. Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave të Radio Televizionit Shqiptar, dhe disa operatorëve të tjerë radioteleviziv për akreditim për vëzhgimin e zgjedhjeve”. Kemi vlerësimin e raportimeve të veprimtarive të institucioneve publike, për periudhën 28 Prill – 4 Maj 2023, dhe shqyrtimin administrativ të denoncimeve që lidhen me këtë periudhë ndaj disa institucioneve. Denoncimet me nr. 352 ID, 353 ID, 371 ID, 372 ID, 373 ID, 374 ID, 375 ID, 376 ID, 377 ID, 378 ID, 380 ID, 381 ID, 382 ID, 383 ID, 384 ID, 385 ID, 388 ID, 389 ID dhe 357 ID, 358 ID, të gjitha këto të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Koalicioni Bashkë Fitojmë; Pika e katërt vlerësimi i veprimtarisë së institucioneve publike për periudhën 05 Maj – 10 Maj 2023, dhe denoncimeve që lidhen me këtë periudhë; Shqyrtimin administrativ të denoncimeve me nr. 393 ID të Qendrës “Qëndresa Qytetare”, të denoncimit nr. 394 ID, të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, të denoncimeve nr. 395 ID, 396 ID, 397 ID, të z. Ivi Kaso, pra nga Koalicioni Bashkë Fitojmë dhe këto, si dhe denoncimet e KRIIK nr. 398 ID, 399 ID, 400 ID, 401 ID, 402 ID, 403 ID; Kemi shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 404, nga zoti Ivi Kaso për hapjen e zyrave zgjedhore në kundërshtim me Kodin Zgjedhor nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”; Shqyrtimi administrativ të denoncimit nr. 405, po i bërë nga zoti Ivi Kaso për ndalim të publikimit të sondazheve tej afatit të përcaktuar nga ligji, nga disa operatorë radioteleviziv; Shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 406, nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për afishimin e materialeve propagandistike të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” në Bashkinë Himarë; Kemi shqyrtimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 deri 10 maj 2023; Pastaj kemi shpalljen e vendimit për denoncimet nr. 364 ID, 366 ID, 367 ID dhe 368 të KRIIK. Pika të tjera në rend të ditës janë: Projektvendimi “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në Bashkinë Belsh dhe Bashkinë Kamëz; Shqyrtimi i denoncimit nr. 407 nga organizata KRIIK në lidhje me publikimin e sondazheve nga televizioni Klan dhe Report TV; Shqyrtimi i denoncimit nr. 408 nga zoti Ivi Kaso, ndaj Partisë Socialiste për hapjen e një zyre zgjedhore në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor pranë KZAZ-së Katundi Ri. Mirë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës në mënyrë të përmbledhur.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Z. Y. Merkaç: Misioni i Vëzhgimit të OSBE/ODIHR i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 98 (nëntëdhjetë e tetë) përkthyesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Parlamenti Evropian i ka paraqitur kërkesën Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për akreditimin e 10 (dhjetë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 4 (katër) përkthyesve. Instituti Demokratik Amerikan (NDI) i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 5 (pesë) vëzhguesve. Ambasada Italiane ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve dhe përkthyesve. Ambasada Amerikane i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, për akreditimin e 14 (katërmëdhjetë) vëzhguesve dhe 15 (pesëmbëdhjetë) përkthyesve. Ambasada Sllovene i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve dhe 2 (dy) përkthyesve. Kërkesat dhe dokumentacionet e paraqitura janë në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe si të tilla duhet të pranohen. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e vëzhguesve të cilët duhen miratuar. Ju faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Meqenëse kërkesat janë në përputhje me parashikimet e ligjit, Kodit Zgjedhor, miratojmë kërkesën për akreditim të vëzhguesve të Misionit Ndërkombëtar të vëzhgimit të zgjedhjeve OSBE/ODIHR, të Parlamentit evropian, të Ambasadës Italiane, të Ambasadës Amerikane dhe të Ambasadës Sllovene.

Vendimi nr. 484

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

**11.05.2023
Ora 12:16**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave të Radio Televizionit Shqiptar, TV 6+1 Vlora, NTV Televizion, Scan TV dhe gazetës online “SI”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë.

Z.Y. Merkaj: Radiotelevizioni shqiptar ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër) gazetarëve. Televizioni “6+1Vlora” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 6 (gjashtë) gazetarëve dhe operatorëve. Televizioni “SCAN” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 13 (trembëdhjetë) gazetarëve. Televizioni “NTV” ka paraqitur kërkesën, për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve. Gazeta online “Si” ka paraqitur kërkesën, për akreditimin e 7 (shtatë) gazetarëve. Kërkesat e paraqitura janë në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe si të tilla duhet të pranohen. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit, atëherë miratojmë edhe kërkesat e këtyre operatorëve radioteleviziv për akreditim të vëzhguesve të zgjedhjeve të datës 14 maj.

Vendimi nr. 485

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publiketë
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

11.05.2023
Ora 12:17

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 4 Maj 2023, dhe shqyrtimin administrativ të denoncimeve me nr. 352 ID, 353 ID, 371 ID, 372 ID, 373 ID, 374 ID, 375 ID, 376 ID, 377 ID, 378 ID, 380 ID, 381 ID, 382 ID, 383 ID, 384 ID, 385 ID, 388 ID, 389 ID të z. Ivi Kaso dhe denoncimet nr. 357 ID, 358 ID, nr. 390 ID, të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja**

• **Parti Politike:** **S’ka**

• **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës. Vlerësimin e veprimtarisë së institucioneve publike, për periudhën 28 prill - 4 maj.

Znj. M. Koja: Sot kemi shpalljen e vendimit për periudhën e monitorimit nga data 28 prill – 4 maj. Gjatë kësaj periudhe siç u relatua dhe në seancën e kaluar janë raportuar gjithsej 123 aktivitete nga 42 institucione. Nga verifikimi rezulton se nga këto aktivitete 11 janë zhvilluar në tejkalim të afatit ligjor. Arsyet e raportimit jashtë afatit ligjor janë ato të relatuara në seancën e kaluar dhe nuk përbëjnë provë të mjaftueshme për ti vendosur sanksion administrativ këtyre institucioneve. Në

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

këto kushte propozojmë pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon “Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura”; “Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier”; Bashkitë, Tiranë, Devoll, Kavajë, Libohovë, Mallakstër dhe Tropojë.

Z. I. Celibashi: Dakord! Në lidhje me institucionet e tjera? Apo janë të gjitha pastaj të periudhës 5 maj – 10 maj?

Znj. M. Koja: Do të vijojmë me trajtimin e denoncimeve për këtë periudhë? Kemi administruar disa denoncime.


Z. I. Celibashi: Po të gjitha denoncimet.

Znj. M. Koja: dakord!

Z. I. Celibashi: Flasim për periudhën 28 prill – 4 Maj.

Znj. M. Koja: Po, pikërisht në këtë periudhë janë administruar disa denoncime që përkojnë me periudhën tonë të monitorimit. Konkretisht është denoncimi i bërë nga zoti Ivi Kaso ndaj Bashkisë Durrës, për një veprimtari me përmbajtje elektorale. Denoncimi me nr. 352 ID. Në seancën e kaluar kemi relatuar. Kemi patur të pranishëm dhe palët, Bashkinë Durrës dhe Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës. Bëhet fjalë për një takim të kandidatës të Partisë Socialiste në Bashkinë Durrës, zonjës Sako me pjesëmarrje të gjimnazistëve të shkollës “Naim Frashëri” dhe “Gjergj Kastrioti”. Ne propozojmë pushimin e hetimit administrativ për sa kohë nuk u arrit të provonte se kemi të bëjmë me përdorim të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

detyruar dhe të organizuar në fushatë zgjedhore brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit parauniversitar. Nuk u provua dhënia e premtimeve apo ofrimi i premtimeve nxënësve për të marrë pjesë në këtë aktivitet nga asnjë prej palëve denoncuese. Kështu që në këto kushte nuk konstatojmë shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe kërkojmë pushim të hetimit administrativ.

Z. I. Celibashi: Dakord! I relatojmë të gjitha denoncimet dhe përfaqësuesit e disa institucioneve që lidhen me periudhën 05 – 10 maj.

Znj. M. Koja: këto janë për periudhën që raportuam më lart. Janë shpallje vendimesh në pjesë e madhe prej tyre. Kemi denoncimin e nr. 353 ID, denoncues zoti Ivi Kaso. Palë e denoncuar është Komiteti i Investimeve Strategjike, Këshilli i Ministrave në lidhje me miratimin e statusit “investitor strategjik” për projektin e investimit “Green House Korça Resort“ me anë të Vendimit 29/4 datë 01.02.2023, nga ana e Komitetit të Investimeve Strategjike”. Në seancën e kaluar përfaqësue të AIDA-së ishin të pranishëm dhe dhanë pretendimet e tyre. Në përfundim të hetimit administrativ ne vlerësojmë se kjo është një veprimtari e cila është e ndaluar në kuptim të vendimit nr. 9, por nga hetimi administrative dhe nga provat që kemi administruar nuk u provua qëllimi zgjedhor për të cilin mund të ishin vënë në dispozicion asete prona publike. Konkretisht vendimi nr. 9 ndalon vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme për qëllime zgjedhore që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror dhe vendor. Në këto kushte për sa kohë nuk u arrit të provohej ajo çfarë ligji e ndalon, ne propozojmë pushimin e hetimit administrativ dhe moskonstatim të shkeljes për këtë rast.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Z. I. Celibashi: Dakord! Edhe në këtë rast do të vendosim pushimin e hetimit administrativ për këtë çështje, pasi e kemi konsideruar veprimtari që është në përputhje me portofolin e institucionit.

Znj. M. Koja: Denoncimi vjen nga zoti Ivi Kaso ndaj Bashkisë Durrës, subjektit zgjedhor të Partisë Socialiste, zonjës Emirjana Sako në lidhje me tenderim për asfalt elektoral e punime të tjera infrastrukturore, abuzim me portin dhe me fondet etj.. Pretendohet që në faqen facebook të Kryetares së Bashkisë, promovohen investime, me fonde të vëna rishtazi. Ne kemi dëgjuar pretendimet në seancën e kaluar edhe të Bashkisë Durrës dhe në përfundim të hetimit administrativ konstatojmë se bëhet fjalë për një aktivitet në përmbushje të detyrave funksionale të zonjës Sako, e cila në cilësinë Kryetarit të Bashkisë Durrës, ka përmbushur detyrat që asaj i burojnë nga ligji. Denoncuesi pretendon se në faqen facebook të Kryetares së Bashkisë, promovohen investime, me fonde të vëna rishtazi. Që të kemi shkeljen e kësaj dispozite, duhet të vërtetohet se fondet e projekteve që promovohen, janë të vendosura në dispozicion rishtazi, pra brenda periudhës 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve”. Vlerësohet dhe nga sa u verifikua këto fonde nuk janë vënë në këtë periudhë. Janë të vendosura në dispozicion përpara periudhës së ndaluar nga ligji. Gjithashtu, u vlerësua se postimet në llogaritë personale në rrjetin social “facebook” të Kryetares së Bashkisë, nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të konstatuar shkelje. Për sa analizuam më lart, vlerësojmë se duhet të pushohet procedimi administrativ dhe moskonstatimi i shkeljes.

Z. I. Celibashi: Dsakord! Edhe në këtë rast do të vendosim pushimin e procedimit administrativ ndaj Bashkisë Durrës. Vazhdojmë me denoncimet e tjera.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publikë të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Znj. M. Koja: Denoncimi i bërë nga zoti Ivi Kaso ndaj Bashkisë Durrës. Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës. Denoncimi me nr. 372 ID. Bëhet fjalë për inagurim të shkollës “Dhosi Liperi“ në Sukth, me pjesëmarrjen e kryetares së bashkisë së Durrësit dhe kandidatës për këtë bashki zonjës Sako dhe Ministres së Arsimit zonjës Evis Kushi. Ky aktivitet është i raportuar në ndërfaqen e KQZ-së në 28 Shkurt për tu zhvilluar në datën 7 Mars. Në përfundim të hetimit administrativ konstatojmë se Bashkia Durrës, e ka raportuar aktivitetin në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe brenda afatit ligjor. Referuar të dhënave të raportuara në ndërfaqe është vlerësuar se vepimtaria është në përmbushje të kërkesave ligjore dhe konsiderohet si e lejuar për tu kryer. Denoncuesi pretendon se në faqen “facebook” të Kryetares së Bashkisë, promovohen investime, me fonde të vëna rishtazi. Gjatë hetimit rezultoi, se fondet për kryerjen e këtyre punimeve, janë vënë në dispozicion para periudhës së parashikuar nga ligji për tu ndaluar, duke mos konstatuar shkeljen e kësaj dispozite. Për sa më lart sugjerojmë dhe vlerësojmë të pushohet hetimi administrativ dhe moskonstatimi i shkeljes.

Z. I. Celibashi: Dakord! Vazhdojmë me të tjerat.

Znj. M. Koja: Kemi denoncim nga zoti Ivi Kaso ndaj Bashkisë Krujë. Bashkia e Krujës shpërndan grante për riparimin e ndërtimin e banesave të dëmtuara nga tërmeti 3.5 vite pas fatkeqësisë natyrore dhe vetëm pak ditë përpara datës së zgjedhjeve. Edhe për këtë rast kemi hetuar. Kemi administruar pretendimet e palëve dhe nga verifikimi i fakteve të administruara dhe pas shqyrtimit të provave për këtë çështje konstatohet se grantet e miratuara nëpërmjet akteve ligjore nuk janë vënë në dispozicion në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve, por janë

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

vënë më herët në dispozicion. Në përfundim të hetimit administrativ vlerësojmë se veprimtaria e Bashkisë Krujë nuk përfshihet në Kategorinë e veprimtarive të ndaluara sipas vendimit nr. 9. Ajo është një veprimtari, proces në vijimësi që ka të bëjë me emergjencën nga fatkeqësia natyrore dhe lëvrimi i granteve për familjet e dëmtuara nga tërmeti. Është realizuar me fonde publike sipas planit buxhetor të miratuar përpara 4 muajve para datës së zgjedhjeve. Edhe në këto kushte mendojmë që të pushohet hetimi administrativ dhe moskonstatimi i shkeljes për rastin e Bashkisë Krujë.

Z. I. Celibashi: Dakord! Edhe për këtë rast do të vendosim pushimin e procedimit administrativ.

Znj. M. Koja: Denoncues Ivi Kaso ndaj Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Librazhd. Veprimtari në shpërdorim të burimeve publike. Denoncimi me nr. 374 ID. Në fakt gjatë hetimit ne kemi nevojë për të thelluar edhe më tej administrimin e provave dhe fakteve dhe propozojmë që lidhur me këtë denoncim të vijojë pak më tej hetimi administrativ, përpara se të dalim me vendimmartje.

Z. I. Celibashi: Ju keni kërkuar shpjegime për këtë?

Znj. M. Koja: Po kemi kërkuar. Kanë ardhur disa pretendime nga Bashkia Librazhd. Nga personi përgjegjës nuk kemi marrë informacion. Mendojmë që duhet ta analizojmë më tepër këtë çështje.

Z. I. Celibashi: Mirë dakord! E shtymë.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Znj. M. Koja: Kemi një denoncim tjetër nga zoti Ivi Kaso. Bashkia Elbasan dhe palë të denoncuara janë Bashkia Elbasan, subjekti zgjedhor Partia Socialiste, kandidati zoti Gledian Llatja, ZVA Elbasan, Ministria Elva Margariti, Ministria Evis Kushi, drejtuesi i Pallatit të Sportit "Tomorr Sinani", Qendra Rajonale e Formimit Profesional. Bëhet fjalë për veprimtari të Kryetarit të Bashkisë, zotit Llatja të publikuar në rrjetin e tij social "facebook", takime dhe promovime siç janë me zonjën Margarita, me zonjën Gjikhuri bonusi për rijetësimin për pronarë e përdorues të objekteve të ndryshme. I pranishëm bashkë me zonjën Kushi dhe zotin Gjikhuri gjatë aktivitetit në pallatin e sportit "Tomorr Sinani" Elbasan. Promovon projekte infrastrukturore në shkollën "Luigj Gurakuqi", "Konstandin Kristoforidhi" në shkollën "Onufri" Elbasan. Bashkë me zonjën Muzhaqi dhe nxënës në Qendrën Rajonale të Formimit Profesional dhe Qendren Rinore Elbasan, prezantojnë kurset e kodimit me mbështetje nga qeveria. Me zotin Gjikhuri, zoti Llatja promovon Auto Moto Park Albania. Promovon rritjen e pagave të punonjësve. Me zotin Gjikhuri promovojnë investime në fabrikën "M&M Topuzi Konstruksiione Metalike" Elbasan. Për këto raste është objekti i denoncimit. Kemi administruar pretendimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Elbasan. Subjekteve të tjera të denoncuara u është kërkuar informacion, por deri më tani nuk kemi marrë pretendime nga ana e tyre. Edhe për këtë rast propozojmë të vijojmë më tej me hetimin administrativ.

Z. I. Celibashi: Ju keni dërguar të gjithë institucioneve të përfshira në denoncim kërkesën për të dhënë sqarime?

Znj. M. Koja: Janë shumë institucione të përfshira.

*Zbardi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Z. I. Celibashi: Ka ndonjë prej tyre që ka kthyer përgjigje?

Znj. M. Koja: Po kanë sjellë përgjigje dy institucione. Konkretisht ka sjellë Zyra Vendore e Arsimit Elbasan dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ndërkohë i është kërkuar edhe institucioneve të tjera, Ministrit për Rininë, Qendrës Rajonale të Formimit Profesional, Ministrit të Kulturës.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*


Z. I. Celibashi: Po vazhdojmë!

Znj. M.Koja: Është denoncimi nga zoti Ivi Kaso ndaj Bashkisë Berat. Në denoncim pretendohet që zoti Ervin Demo, Kryetar i Bashkisë Berat promovon shtrimin e asfaltit dhe përmirësimin e kushteve të qytetit në kohë fushate. Bashkia Berat ka dhënë pretendimet e saj, nga hetimi i kryer rezultojnë se në rrjetin social të Bashkisë Berat, nuk është shpërndarë asnjë postim me këtë përmbajtje. Gjithashtu nga përgjigja e bashkisë rezultojnë se punimet e kryera kanë filluar që prej vitit të kaluar dhe vazhduan deri në përfundimin e tyre. Pra këto veprimtari janë në kuadër të detyrave funksionale të bashkisë dhe Kryetarit të bashkisë. Sa më sipër, rezultoi se veprimtaria objekt denoncimi, nuk përbën veprimtari me karakter publik për tu raportuar dhe nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor (neni 91 dhe 92) dhe të nenit 3 dhe 4, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Në këto kushte propozojmë pushimin e hetimit dhe mos konstatimin e shkeljes.

Z. I. Celibashi: Po dakord, edhe në këtë rast do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ.

Znj. M. Koja: Denoncimi tjetër është nga zoti Kaso ndaj zotit Blendi Gonxhe/ të Partisë Socialiste. Për një veprimtari në shpërpërdorim të burimeve publike denoncimi me nr. ID 377. Shpërdorim i taksave të qytetarëve për fushatë elektorale, nga ana e z. Blendi Gonxhe. Në vijim të hetimit administrativ janë ftuar palët për të marrë pjesë në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk pati asnjë

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

përfaqësues. Pasi u shqyrtuan pamjet filmike, provat dhe faktet, ne vlerësojmë se veprimtaria e kryer nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr.9, të Komisionit Rregullator. Nga hetimi i kryer rezulton që veprimtaria e denoncuar « Retro Tirana », me vend zhvillimi në sheshin «Skënderbej», datë zhvillimi 29 prill, është raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ- së nga DPSHTRR datë 19.4.2023, brenda afatit ligjor. Nga këqyrja e materialit që është vënë në dispozicion, nuk rezulton që në këtë aktivitet të ketë shpërdorim të fondeve publike apo të jenë bërë thirrje për të votuar, pra të ketë një karakter elektoral por është një veprimtari publike në kuadër të funksionalitetit të institucionit. Për këtë rast propozojmë pushimin e hetimit administrativ dhe mos konstatimin e shkeljes.

Z. I. Celibashi: Po dakord edhe në këtë rast do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ.

Znj. M. Koja: Denoncimi i rradhës është ndaj Bashkisë Pukë, denoncues zoti Ivi Kaso, ndaj kandidatit të Partisë Socialiste zotit Gjon Gjonaj denoncimi me nr.ID 378 .Promovim i përmirësimit infrastrukturor në fshatin Gojan, Bashkia Pukë. Kërkohej të merren masa nga ana e KQZ-së, kemi njoftuar Bashkinë Pukë për të dhënë shpjegime për rastin në fjalë nuk kemi administruar informacion nga ana e tyre Nga verifikimi i fakteve të administruara dhe pas shqyrtimit të provave dhe materialit filmik të administruar, ne nuk u arritëm të bëjmë identifikim të palëve në këtë aktivitet dhe as tematika e veprimtarisë. Në kushtet kur rezulton se nga faktet e administruara për objektin në rast hetimi, nuk ka prova të mjaftueshme për të vlerësuar mbi shkeljen e pretenduar, propozojmë pushimin e hetimit administrativ për këtë rast.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Z. I. Celibashi: Edhe për këtë rast do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ.

Znj. M. Koja: Denoncimi i rradhës është ndaj Bashkisë Durrës, denoncues zoti Ivi Kaso, denoncimi nr. ID 380. Është palë e denoncuar Bashkia Durrës, Zyra Vendore Arsimore Para Universitare Durrës, dhe subjekti zgjedhor Partia Socialiste zonja Emirjana Sako. Në datën 1 Maj, kandidatja e PS për bashkinë Durrës ka përdorur studentë e nxënës të shkollave 9 vjecare në fushatë elektorale. Ky Aktivitet është postuar edhe në rrjetet e saj sociale. Për sa i përket këtij denoncimi ,nga ana jonë është kërkuar informacion Zyrës Vendore Arsimore Durrës dhe Bashkisë Durrës. Ne mendojmë që edhe për këtë rast të vijojmë me hetimin administrativ dhe të mos dalim sot me vendimmarrje.

Z. I. Celibashi: Po dakord.

Znj. M. Koja: Denoncimi i rradhës është ndaj Bashkisë Vlorë, denoncues zoti Ivi Kaso, ZVA Vlorë-Himarë, Bashkia Vlorë, subjekti zgjedhor Partia Socialiste zoti Ermal Dredha kandidat. Kreu i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë së bashku me arsimtarë e drejtues të arsimit Vlorë zhvilluan një takim, elektorale me kandidatin për kreun e bashkisë Vlorë zotin Ermal Dredha. Lidhur me këtë denoncim ne mendojmë të vijojmë hetimin administrative. Përsa kohë nuk kemi administruar ende parashtrime nga Zyra Vendore Arsimore Vlorë-Himar.

Z. I. Celibashi: Po dakord.

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Znj. M. Koja: Denoncimi i rradhës është ndaj Bashkisë Lezhë, Policia e Shtetit/Komisariati Lezhë. Denoncues është zoti Ivi Kaso, në denoncim pretendohet që : Punonjës të Policisë së Shtetit janë të përfshirë në fushatë elektorale të kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë Lezhë zotit Pjerin Ndreu. Siç kemi referuar edhe në seancën e kaluar. Kemi administruar pretendimet e Policisë së Shtetit të bashkisë. Pas hetimit administrativ të kryer nga ana jonë, konstatojmë se nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar faktin nëse në foto janë personat e denoncuar që mbajnë funksione të caktuara në Policinë e Shtetit. Vetë Policia e Shtetit ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, prapësimet e saj ku parashtron se personi në fotoka ngjashmëri me punonjës in e policisë Nikoll Anton Doda, aktualisht me detyrë Oficer i Patrullës së Përgjithshme në Komisar iatin e Policisë Kurbin por nuk është ai. Gjatë intervistimit të punonjës it që Policia e Shtetit ka bërë me punonjës in e policisë është deklaruar se personi në foto që shoqëron denoncimin është ai vetë po është i vëllai , i cili nuk është punonjës policie.Pas hetimit administrativ të kryer, konstatojmë se nuk kemi të bëjmë me një shkelje, sygjerojmë pushimin e hetimit administrativ.

Z. I. Celibashi:Dakord edhe në këtë rast do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ.

Znj. M. Koja:Denoncimi i rradhës është nga zoti Ivi Kaso, ndaj ZVA Elbasan. Takim i organizuar nga drejtuesit e shkollës në fshatin Pekisht, Elbasan me prindërit e nxënësve të kësaj shkolle me qëllim për tu kërkuar informacion atyre lidhur me ndihmën ekonomike dhe përkrahjen sociale që ata marrin ose jo nga shteti. Ne edhe në këtë rast mendojmë të vijojmë me hetimin administrativ për sa kohë ende nuk kemi administruar ende prapësimet e palëve të denoncuar.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publikë të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*


Z. I. Celibashi: Po dakord.

Znj. M. Koja: Denoncimi është ndaj Bashkisë Tiranë, denoncues zoti Ivi Kaso, denoncim me nr. ID 384. Ku pretendohet së në datën 25 Prill Kryetari i Bashkisë zotit Erion Veliaj gjatë takimit me qëllim fushate me bizneset përgjatë rrugës pranë maternitetit "Mbretëresha Geraldinë", ka hasur kundërshtimin e pronarit të një biznesi. Të nesërmen policia bashkiake ka marrë masën e gjobës për këtë biznes, si hakmarrje ndaj sjelljes së pronarit. Ne kemi administruar pretendimet dhe faktet që parashtron policia bashkiake, e cila konfirmonë që në datë 25 Prill, gjatë një kontrolli të ushtruar në këtë zonë kanë konstatuar se subjekt privat ka zënë hapsirën publike me çadër, pa leje përkatëse nga Bashkia Tiranë. Për sa më sipër, ndaj subjektit në fjalë është marrë masë administrative dhe është liruar hapsira e zënë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Ata na informojmë se pas verifikimeve të bëra ka rezultuar se Kryetari i bashkisë Tiranë nuk ka qenë prezent me datë 25 Prill në Bulevardin "Zogu i Parë" sikundër pretendohet nga denoncuesi. Në mungesë të hetimit të mëtejshëm të provave që kemi në dispozicion, ne propozojmë pushimin e hetimit administrativ për këtë rast.

Z. I. Celibashi: Dakord edhe për këtë rast do të vendosim pushimin administrativ, të shqyrtimit administrativ për këtë çështje.

Znj. M. Koja: Denoncimi tjetër është ndaj Bashkisë Tiranë nga denoncues zoti Ivi Kaso. Denoncimi me numër ID. 385. Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, me miratimin e Kryeministrit, pak ditë përpara zgjedhjeve miraton 7 (shtatë) leje të reja ndërtimi për kulla në Tiranë. Bashkia Tiranë ka sjellë këtë prapësim Bashkia e Tiranës në përputhje me parashikimet e legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

e territorit është institucion vendor, ndërsa Këshilli Kombëtar i Territorit është organ kolegjal që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri. Mbledhja objekt denoncimi është një mbledhje e Këshillit Kombëtar të Territorit. Kërkon pushimin e hetimit administrativ ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Ne mendojmë që të marrim pak më shumë kohë për të proceduar me hetimin në këtë rast, të shpallim vendimin në një moment tjetër.

Z. I. Celibashi: Po dakord, do kërkojmë informacion shtesë në lidhje me këtë çështje.

Znj. M. Koja: Denoncues zoti Ivi Kaso ndaj Bashkisë Durrës, denoncimi me numër ID 388. Zyra Vendore Arsimore Durrës, kandidatja zonja Emirjana Sako. Bëhet fjalë për një veprimtari të zhvilluar nga Kryetarja e Bashkisë Durrës, Ministrja për Rininë, Kryeministr kanë marrë pjesë në takime elektorale në qytetin e Durrësit së bashku me nxënës e staf arsimor. Një nga këto aktivitete është edhe mbjellja e pemëve në Porto Romano. Ne i kemi thirur palët, i kemi dëgjuar në seancën e kaluar si ZVA Durrës ashtu edhe Bashkinë Durrës. Duke qenë se ne e kishim të paqartë se në cilin ambient ishte zhvilluar veprimtaria, tani e kemi këtë informacion bëhet fjalë për një shkollë jo publike Shkolla « Migjeni » e cila ka ftuar palët e cituara më lartë me rastin e 20 vjetorit të kësaj shkolle. Në kuadër të këtij aktiviteti është bërë edhe mbjellja simbolike e disa pemëve. Për sa më lart ne propozojmë pushimin e hetimit administrativ për këtë rast dhe mos konstatim të shkeljes nga palët e denoncuara.

Z. I. Celibashi : Po dakord edhe për këtë rast do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Znj. M. Koja: Ndërkohë denoncimi i rradhës është ndaj Bashkisë Fier, denoncues zoti Ivi Kaso. Denoncim me numër ID 389. Punonjësit e Bashkisë Fier kushtëzojnë shërbimin kundrejt qytetarëve të cilët paraqiten pranë këtij institucioni publik dhe nuk ofrojnë shërbim ndaj tyre, derisa të ketë konfirmuar statusin "pëlqyer" (like), për veprimtarinë e publikuar nga kryetari i bashkisë. Ne kemi kqyrur në fakt pamje filmike që janë të disponueshme. Nga pamjet filmike vërehet një punonjëse e cila gjatë momentit që është duke ofruar shërbimin thjesht shikon celularin e saj po nuk ka një komunikim ndërmjet saj dhe personit që është përballë në sportel. Për më tepër ne mendojmë që të pushojmë hetimin administrativ edhe për mungesë kompetence të KQZ-së në këtë rast mbi sjelljen e punonjësës. Pasi edhe nga sa pretendohet nuk provohet dotë nga ato pamje filmike që ofrohen në faqen Web.

Z. I. Celibashi : Po dakord edhe për këtë rast do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ.

Znj. M. Koja: Denoncimi ndaj Bashkisë Maliq për një veprimtari me përmbatje elektorale, denoncimi me numër ID 390. Denoncues është Koalicioni Bashkë Fitojmë. I Denoncuar, Kryetari i Bashkisë Maliq. Pjesëmarrja e administratës së bashkisë Maliq në takimin elektorale të Kryeministrit Rama në këtë qytet në datën 2 Maj në orën 14:30. Ne kemi administruar pretendimet e Bashkisë Maliq ku konfirmohet një pjesë e pjesëmarrësve janë punonjës së administratës. Por ajo pretendon që janë me leje në atë periudhë në momentin që kanë marrë pjesë kështu që duke qenë se çështja është më komplekse dhe janë shumë persona të denoncuar, të përfshirë në këtë hetim. Sugjerojmë që të vijoj më tej hetimi dhe mos ta shpallim vendimin sot.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Z. I. Celibashi : Dakord, i kërkohet shpjegim dhe informacione shtesë në lidhje me këtë çfarë kanë paraqitur në shpjegimin e tyre.

Vendimi nr.486

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

11.05.2023
Ora 12:46

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 05 Maj – 10 Maj 2023, dhe shqyrtimin administrativ të denoncimeve me nr. 393 ID të Qendrës “Qëndresa Qytetare”, të denoncimit nr. 394 ID, të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, të denoncimeve nr. 395 ID, 396 ID, 397 ID, të z. Ivi Kaso, të denoncimeve nr. 398 ID, 399 ID, 400 ID, 401 ID, 402 ID, 403 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z.Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:** **KRIK, OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Atëherë, së bashku me denoncimet që ka bërë “Qëndresa Qytetare”, subjekti Bashkë Fitojmë dhe KRIK. Për veprimtarinë e institucioneve publike për këtë periudhë 5- 10 Maj. Kështu që relatoi gjetjet tona sipas raportit por edhe denoncimet e Qëndresës, Bashkë Fitojmë dhe të KRIK. Pastaj vazhdojmë me shpjegimet e përfaqësuesve të institucioneve që mund të jenë prezent këtu.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Znj. M. Koja: Gjatë periudhës 5 Maj -10 Maj 2023 në ndërfaqen e raportimeve publike janë raportuar gjithësej 51 veprimtari. Nga 16 institucione nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto institucione 7 prej tyre kanë raportuar në tejkalim të afateve. Konkretisht është Ministria e Kulturës, Banka e Shqipërisë, Bashkia Bulqizë, Devoll, Korçë, Rrogozhinë edhe Tiranë. Nga sa kemi hetuar Ministria e Kulturës nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për aktivitetin, pasi ajo ka qenë në cilësinë e të ftuarit dhe kjo është provuar. Për sa i përket Bankës së Shqipërisë tematika e aktivitetit është takimi i Guvernatorit Sejko me përfaqësues të shoqateve të bizneseve eksportuese. Për nga natyra e saj na u krijua bindja që kjo është një veprimtari administrative dhe jo me detyrim për raportim në vetvete. Bashkia Bulqizë ka bërë një gabim në përlllogaritjen e afatit dhe të raportimit në ndërfaqe. Për këtë arsye ata nuk e kanë zhvilluar aktivitetin por e kanë shtyrë për në 13.05 pra brenda në respektim të afatit ligjor. Bashkia Devoll edhe ajo ka bërë një gabim material në raportim edhe është ri raportuar veprimtaria në respektim të afateve ligjore për tu zhvilluar në datën 15.05. Bashkia Korçë ne mendojmë që për shkak të tematikës që është Festivali 56 i Kengës për Fëmijë nuk ka detyrim për raportim. Nuk mendojmë të propozojmë sanksion për këtë rast. Bashkia Rrogozhinë ka kryer gabim në hedhjen e të dhënave duke u referuar në muajin pararendës në fakt data e zhvillit është 12.05 dhe është brenda afatit ligjor thjesht ka bërë referim në Muajin Prill. Ndërsa për sa i përket Bashkisë Tiranë, ka raportuar mbledhjen e Këshillit Bashkiak dhe kjo është një veprimtari e cila nuk mbart detyrim për tu raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në këto kushte propozojmë pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve që relatuar.

Z. I. Celibashi: Nëse nuk kemi pretendime të tjera të paraqitura nga denoncuesit dhe shpjegimet që kanë dhënë institucionet e denoncuarat janë mjaftueshëm sqaruese.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Atëhere do të vendosim pushim e hetimit administrativ. Ndërkohë vazhdojmë me vlerësimin e denoncimeve.

Znj. M. Koja:Atëherë, gjatë kësaj periudhe kemi administruar këto denoncime. Denoncues është “Qëndresa Qytetare” ndaj Kryetares së Bashkisë Durrës. Denoncim me numër ID 393. Me këtë objekt denoncimi: Në datë 11 Prill 2023 subjekti zgjedhor “Pastia Socialiste”, çeli fushatën elektorale për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj dhe në këtë aktivitet, ka qënë e ftuar edhe zj. Emiriana Sako në cilësinë e Kryetares së Bashkisë Durrës dhe njëkohësiht kandidates për këtë bashki. Ky aktivitet është publikuar ne rrjetet sociale të zonjës Sako si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës. Nga ana e Bashkisë Durrës kemi administruar edhe prapësimet e tyre. Ata shprehen se ky aktivitet është publikuar në faqen zyrtare të kryeministrit, ndërkohë, gabimisht disa nga fotot e këtij aktiviteti janë shpërndarë edhe në faqen zyrtate të facebook-ut të Bashkisë Durrës, nga përdoruesit e tij. Duke e konsideruar një lapsus shpërndarjen e tyre, nga administratori janë marrë menjëherë masat për heqjen e tyre.Sqarojmë edhe një herë se ky aktivitet nuk është pasqyruar nga znj. Emiriana Sako. Gjithashtu mund të shihet qartë dhe sot që ne faqen zyrtare të facebook-ut të Bashkisë Durrës nuk është publikuar asnjë aktivitet me karakter politik. Këto janë pretendimet e Bashkisë Durrës, ata kërkojnë mirëkuptimin për mos marrjen e sanksioneve administrative nda tyre, për shkak të lapsusit të bërë. Ne jemi në fazën të shqyrtimit administrativ, të hetimit palët janë të ftuara dhe mund të paraqesin pretendimet e tyre shtesë.

Z. I. Celibashi: Po përfaqësuesi i Bashkisë Durrës!

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Përfaqësuesi i Bashkisë Durrës: Është e vërtetë, në fakt diçka e tillë ka ndodhur, por është një gabim njerëzor, janë marrë masat menjëherë nga drejtori i kabinetit, janë urdhëruar heqjet e fotove dhe nga ai moment e mbrapa nuk ka pasur asnjë foto dhe asnjë publikim të kësaj natyre që shkel dispozitat ligjore. Këtu natyrisht kërkojmë ndjesë për incidentin, nuk është diçka në vazhdim.

Z. I. Celibashi: Këto postime nuk janë vënë në faqen e facebook-ut të bashkisë?

Përfaqësuesi i Bashkisë Durrës: Janë në faqen, nuk janë hedhur në faqen e Bashkisë Durrës, por i është bërë shpërndarja nga faqja e Kryeministrit te faqja e bashkisë.

Z. I. Celibashi: Dakord, tani nuk janë më?

Përfaqësuesi i Bashkisë Durrës: Nuk janë, janë hequr që nga momenti kur janë konstatuar dhe është një gabim njerëzor që ne e konsiderojmë...

Z. I. Celibashi: Unë mendoj që dhe aq gabim nuk është por gjithsesi fakti që tashmë është kuptuar nga të gjitha institucionet që nuk mundet në faqet e tyre të internetit apo në profilet e tyre zyrtare të publikojnë aktivitete elektorale, përfshirë këtu edhe të kryeministrit, apo Kryetarit të Partisë Socialiste, mendoj që kaq është e mjaftueshme për ta vlerësuar këtë çështje të mbyllur dhe për të mos vendosur sanksion administrativ përsakohë që është korigjuar ai gabim, realisht nuk mendoj që jemi në kushtet për të vendosur sanksion. Kështuqë do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ për këtë çështje. Po vazhdojmë.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Znj. M. Koja: Denoncimi tjetër është nga Koalicioni ‘Bashkë Fitojmë’, i denoncuar Kryetari i Bashkisë Roskovec, denoncim me numër ID 394, tansmetimi i emisionit Piranja, ku përfshihej personalisht Kryetarja e Bashkisë Roskovec, zonja Bufi, e cila në ndikimin e presionit, pozicionit publik të kryetarit të bashkisë, 9 ditë para zgjedhjeve kërcënon hapur punonjësit e administratës me largim nga puna, për të përfituar avantazhe elektorale. Ne kemi administruar një pjesë të pretendimeve nga zonja Bufi, por ndërkohë kemi administruar dhe një kërkesë zyrtare të saj për ta shtyrë seancën e sotme pasi e ka të pamundur të vij personalisht, për të marr një avokat, për tu paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për këtë hetim.

Z. I. Celibashi: Po dakord, do të vendosim ta shtyjme shqyrtimin e kësaj çështje një ditë tjetër. Po.

Znj. M. Koja: Denoncimi është nga zoti Ivi Kaso, ndaj Kryetarit të Bashkisë Kamëz, denoncim me numër ID 395. Disa ditë përpara zgjedhjeve kandidati i PS-së për Bashkinë Kamëz, njofton rrjetin e tij facebook, se bashkë me Ministren e Arsimit Evis Kushi dhe Zv/ministren Balluku, marrin pjesë për fillimin e punimeve për ndërtimin e shkollës ‘Hilary Clinton’. Promovimi i punimeve të kryera në çerdhen ‘Dielli’ në Kamëz, promovim projektsh punimesh në disa shkolla të tjera të Bashkisë Kamëz. Kemi administruar pretendimet një nga një, i kemi thirrur sot të jenë të pranishëm në seancë, jemi në fazën e shqyrtimit të këtyre pretendimeve.

Z. I. Celibashi: Po, shoh që kemi përfaqësuesën e Ministrisë së Arsimit, nga Bashkia Kamëz, nuk kemi. Po.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Përfaqësuesi i Ministrisë Arsimit: Atëhere përshëndetje, referuar denoncimit me numër ID 395, ku pretendohet se në aktivitetet e pasqyruara në rrjete sociale janë nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, datë 16.02.2023, paraqitet Ministria e Arsimit dhe Sporteve, zonja Evis Kushi, e cila ka marrë pjesë në ceremoninë për nisjen e punimeve për ndërtimin e shkollës 9 vjeçare ‘Hilary Clinton’, Bashkia Kamëz, sqarojmë se ky aktivitet lidhet me fillimin e punimeve për ndërtimin e shkollës ‘Hilary Clinton’ Kamëz, e shembur nga tëmeti, me grante të qeverisë gjermane. Ministria Evis Kushi në këtë aktivitet ka qënë e ftuar sepse ka qënë një aktivitet i organizuar nga Bashkia Kamëz, gjithashtu ky aktivitet është raportuar nga personi përgjegjës i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me datë 10.02.2023, brenda afatit të përcaktuar, dhe në këto kushte kërkojmë pushimin e procedimit administrativ ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Z. I. Celibashi: Po faleminderit, mendoj që edhe në referim të edhe asaj çfarë ishte shpjeguar dhe ishte paraqitur me shkrim nga përfaqësuesi i institucioneve, por dhe çfarë referoi përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit, mendoj që nuk jemi para shkeljes së Kodit Zgjedhor apo të vendimit numër 9 të Komisionit Rregullator, kështuqë do vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ për këtë rast. Po vazhdojmë.

Znj. M. Koja: Denoncimi vjen nga zoti Ivi Kaso, ndaj Bashkisë Gjirokastrë, Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë është i denoncuari. Objekti i denoncimit ka të bëjë me shtrimin e rrugëve, 10 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Ne kemi kërkuar informacion por deri tani nuk kemi administruar asnjë pretendim nga pala. Jemi në fazën e shqyrtimit për këtë rast.

Z. I. Celibashi: Dakord!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Znj. M. Koja: Denoncues është KRIIK ndaj Bashkisë Shkodër, mosraportim i një veprimtarie publike, i denoncuar është personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive në Bashkisë Shkodër, është denoncimi me numër ID 398. Objekt denoncimi është një takim i Kryetarit të Bashkisë Shkodër, zotit Behar Spahia, në zyrën e tij, me nxënës të klasave të katërta të Medresesë Haxhi Shamia, nën drejtimin e një mësueseje, duke përgëzuar stafin pedagogjik dhe drejtuesit e Medresesë për kontributin e tyre në edukimin e brezit të ri. Bashkia sqaron se aktiviteti është organizuar nga shkolla ‘Haxhi Shamia’, në kuadër të kurikulave mësimore me pjesëmarrjen e Kryetërit të Bashkisë dhe mësuesëve. I kemi kërkuar informacion bashkisë për të na vendosur në dispozicion ftesën, email-in, për organizimin e këtij aktiviteti, por deri tani nuk kemi marr ende përgjigje, jemi në fazën e shqyrtimit.

Z. I. Celibashi: Dakord, mirë, do të presim shqarime nga institucioni i Bashkisë Shkodër në lidhje me këtë denoncim.

Znj. M. Koja: Denoncimi vjen nga KRIIK, ndaj Bashkisë Korçë, mosraportim i një veprimtarie publike, denoncim me numër ID 399, i denoncuar është personi përgjegjës për raportim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Objekti denoncimi është inspektim punimesh për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura në Meçan, ku do të ndërtohet një miniinpiant për trajtimin e tyre njësoj si në qytet. Bashkia Korçë shprehet se kjo veprimtari nuk është raportuar pasi është zhvilluar në kuadër të fushatës elektorale, ajo nuk është pasqyruar në faqet zyrtare në rrjetet sociale të bashkisë, dhe në fund të postimit të publikuar është përdorur me hashtag slogani i Partisë Socialiste për fushatën zgjedhore, pra ata pretendojnë që ky

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

është një aktivitet elektoral i postuar në faqen e Kryetarit të Bashkisë dhe për këtë arsye nuk ka pasur detyrim për tu raportuar si veprimtari publike.

Z. I. Celibashi: Po, pretendimi nuk është vetëm për këtë, nëse nuk gabo, nga denoncuesit është edhe për keqpërdorim të...

Znj. M. Koja: Ato kanë thënë për mosraportim të veprimtarisë publike, ky është objekti i denoncimit, dhe është marr informacioni...

Z. I. Celibashi: Cili është në thelb veprimtaria që kanë kryer?

Znj. M. Koja: Veprimtaria është inspektim punimesh për ndërtimin e rrjetit të kanalizime të ujërave të ndotura

Z. I. Celibashi: Po si mund të jetë një veprimtari për inspektim, veprimtari politike dhe elektorale? Gjithsesi do t'i kërkojmë shpjegime në lidhje me këtë denoncim dhe më pas do të vendosim.

Znj. M. Koja: Jemi në fazën e shqyrtimit. Po.

Z. I. Celibashi: O duhet të jetë veprimtari politike elektorale, o veprimtari institucionale. Po, vazhdojmë.

Znj. M. Koja: Denoncues është KRIIK ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Lezhë, për mosraportimin e një veprimtarie publike, denoncimi me numër ID 400, takimi i Kryetarit të Bashkisë Lezhë,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

njëkohësisht kandidati i PS-së për këtë bashki, me arkitekt dhe inxhinjerë duke folur për Bashkinë e Lezhës, projekte për sot dhe nesër. Jemi në fazën e hetimit, u kemi kërkuar shpjegime palëve, presim t'i administrojmë ato. Viojmë me denoncimin e rradhës, është denoncues KRIIK, i denoncuar personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, objekt denoncimi është takimi i Kryetarit të Bashkisë Dibër, njëkohësisht kandidati i Partisë Socialiste për këtë bashki, Ministres së Shëndetësisë, drejtuesit politik të qarkut Dibër, zonjës Balluku, në poliklinikën e re të qytetit, duke premtuar dhe investimin në spitalin rajonal Dibër. Ministria e Shëndetësisë është shprehur se kjo është një veprimtari e raportuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet postës elektronike, duke qënë se ditën e raportimit në ndërfaqe kishte, ishte në proces mirëmbajtjeje, kemi raportuar se aktiviteti do zhvillohej në datën 30 prill 2023. Edhe për këtë rast jemi në fazë të shqyrtimi të provave dhe fakteve dhe në fund do dalim me vendimmarrje.

Z. I. Celibashi: Po, vazhdojmë.

Znj. M. Koja: Denoncues KRIIK për mosraportim të

Z. I. Celibashi: Ka përfaqësues të institucioneve për këtë, për të shpjeguar në lidhje me këtë pikë.

Përfaqësuesi i Ministrisë Shëndetësisë: Përshëndetje, për Ministrinë e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësues Olsi Akshia dhe zonja Alma Dervishaj, referuar aktivitetit duke qënë se faqja Web e në të cilën bëhet raportimi i aktivitetit ishte në, po mirëmbahej, u vlerësua, për rastin konkret të paktën u dërgua me email në lidhje

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

me raportimin. Faqja nuk ishte funksionale, besoj që duhet pushuar për aq kohë sa është zbatuar detyrimi. Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë, do ta vlerësojmë. Po ky është pretendimi juaj dhe shpjegimi juaj në lidhje me...

Përfaqësuesi i Ministrisë Shëndetësisë: Po.

Z. I. Celibashi: Po vazhdojmë me..

Znj. M. Koja: Denoncimi i KRIIK ndaj Bashkisë Kamëz, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Kamëz për mosraportim të një veprimtarie publike, me objekt ceremonia e hapjes së edicionit të dytë të panairit të librit ‘Kamza lexon’, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Bashkisë dhe drejtuesit politik, zonjës Nikolla. Bashkia Kamëz parashtron se nga ana e tyre është realizuar detyrimi ligjor për raportimin e veprimtarisë. Paqartësia nga ana e denoncuesit është krijuar për shkak se ky aktivitet është shtyrë dhe është kryer disa ditë pas datës të cilës është raportuar. Do ta verifikojmë dhe rastin dhe do dalim më pas me vendimmarrje.

Z. I. Celibashi: Po, dakord!

Znj. M. Koja: Denoncimi tjetër ka të bëjë me denoncimin ndaj Kryeministrit, Zv/sekretarit të Kryeministrit, Minishtrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Shpërdorimi i burimeve publike është objek denoncimi, denoncues është KRIIK, denoncim me numër ID 403. Në datën 3 maj Kryeministri, zv/Kryeministrja dhe Ministrja e Energjisë dhe Infrastrukturës, njëkohësisht drejtuese e qarkut politik

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Dibër, zonja Balluku dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonja Manastirlliu, kanë zhvilluar një takim me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit. Aktiviteti është publikuar në rrjetet sociale të të tre institucioneve përkatëse, titullarëve, si dhe ka gjetur pasqyrim në disa media kombëtare dhe lokale. Sipas KRIIK kjo përbën veprimtari të ndaluar, keqpërdorim të burimeve publike dhe të autoritetit shtetëror, në funksion të fushatës elektorale të Partisë Socialiste. Nuk kemi marr ende prapësim nga palët.

Z. I. Celibashi: Ju keni dërguar kërkesë institucioneve për të dhënë shpjegime?

Znj. M. Koja: Po, janë dërguar.

Z. I. Celibashi: Ska përfaqësues të institucioneve? Ministria e Shëndetësisë, po dhe zoti Shaneli besoj nga Kryeministria.

Përfaqësuesi i Kryeministrit: Faleminderit, unë jam këtu në cilësinë e këshilltarit ligjor të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, zotit Edi Rama. Jemi këtu në vlerësim të institucionit tuaj të nderuar dhe të funksionit shumë të rëndësishëm që ju kryeni, sa i takon denoncimit në fjalë më lejoni t'ju siguroj që qëndrimi i qartë i Kryeministrit Rama që në krye të herës, që para fillimit të fushatës zgjedhore e në vijim gjatë gjithë procesit të fushatës zgjedhore, ka qënë dhe mbetet i njëjtë, respektimi i të gjitha kërkesave ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, e në këtë kuptim, i tillë ka qënë edhe qëndrimi edhe në këtë aktivitet të zhvilluar në datën 3 maj. Dua t'ju sqaroj ju, që organizues i kësaj veprimtarie apo i këtij aktiviteti ka qënë ministria e linjës, që në këtë rast është Ministria e Shëndetësisë dhe jo Kryeministria, as zyra e Zv/kryeministrit, është një

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

veprimtari e pastër teknike do të thosha, që i takon veprimtarisë institucionale të zyrave përkatëse dhe asesi nuk mund të ngatërrohet dhe të sillet si veprimtari politike që cënon ligjshmërinë e procesit zgjedhor gjatë fushatës elektorale. I tillë është edhe përshkrimi i këtij takimi dhe sa i takon pretendimit të ngritur nga denoncuesit në rastin në fjalë, për pjesëmarrjen e Zv/kryeminstres, zonjës Balluku në këtë aktivitet, dua të sqaroj që zonja Balluku në këtë aktivitet nuk është e ftuar si drejtuese politike e qarkut të Dibrës, por sikurse e përmenda në fillim të fjalës time, është një takim teknik i realizuar për të bashkëbiseduar për planin 2 vjeçar të rritjes së pagave dhe drejtuese e grupit ndërministror për realizimin e një procesi të tillë ka qënë zonja Balluku. Prandaj insistoj sërish në atë, që ka qënë vetëm takim teknik institucional, i parashikuar. Sa i takon mosnjoftimit nga ana e Kryeminstres për një takim të tillë, e përsëris që nuk ka qënë takim i organizuar nga Kryeministria apo zyra e Zv/kryeministrit, por nga ministria e linjës, përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë është prezent kështu që nuk dua të bëj parashtrimin e asaj pjese, dhe sërish shpreh qëndrimin tonë që për këtë pjesë sa i takon zyrës së Kryeministrit dhe zyrës së Zv/kryeministrit, duhet të pushojë denoncimi i paraqitur, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit. Përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë diçka në lidhje me këtë denoncim, shpjegimet tuaja.

Përfaqësuesi i Ministrisë Shëndetësisë: I nderuar zoti Kryetar, referuar pretendimeve sqarojmë se ato janë të pabazuara përse i përket pikave për përdorimin e burimeve njerëzore dhe për çdo gjë tjetër që thuhet në ankesën e ankuesit. Vlerësojmë që është bërë një raportim i drejtë i veprimeve të administratës publike, në këtë rast pushteti qendror, për programin e rritjes së pagave të personelit mjekësor në shkallë republike, dhe në këtë rast gjithë pjesëmarrësit ishin, po të shikojmë dhe

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

gjithë dokumentat provuese të cilat janë ngarkuar, nuk kemi asnjë provë dhe asnjë fakt, të cilat provojnë pretendimet e kërkuesit në lidhje me, sidomos dispozitiv në pjesën e fundit të kërkesës. Vlerësojmë siç ishte dhe në rastin e mëparshëm, duke qënë se faqja Web ka qënë në mirëmbajtje dhe personi përgjegjës për raportimin mundet që të ketë ndonjë mangësi në kohën e raportimit të këtij aktiviteti dhe vlerësojmë që kjo të merret në konsideratë duke qënë se në raportimin e mëparshëm ka qënë faqja në mirëmbajtje dhe mbase është vlerësuar, qoftë dhe gabimisht mosraportimi të themi në kohë reale i këtij aktiviteti. Gjithsesi dua të theksoj faktin që nuk jemi para ndonjë aktiviteti të ndaluar, jemi para aktiviteti institucional, në të cilin shumë drejt promovohen aktet nënligjore në fuqi të cilat janë të miratuara dhe mbi të gjitha siç është rritja e pagave. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Pas shpjegimit të zyrës së Kryeministrit dhe Zv/kryeministres e kuptuam, ju jeni duke thënë që ky aktivitet është një aktivitet brenda fushës së përgjegjësisë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe për ato qëllime që ju thatë, për njohje dhe vlerësim të akteve që lidhen më aspekte të caktuara të veprimtarisë së institucioneve në fushën e shëndetit publik, dhe nuk ka në asnjë rast thoni ju, keqpërdorim të resurseve publike dhe ky aktivitet ka qënë thjesht vetëm aktivitet institucional, jopolitik, joelektoral. Nuk ka patur në këtë aktivitet po themi, asnjë qoftë edhe nuamcë të një veprimtarie politike dhe elektorale. Kështu është?

Përfaqësuesi i Ministrisë Shëndetësisë: Po i nderuar.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Z. I. Celibashi: Në lidhje me mosraportimin ju pretenduat që mosraportimi është për rrethana objektive teknike të problematikave që lidhen me faqen, ndërfaqen e raportimit.

Përfaqësuesi i Ministrisë Shëndetësisë: Po i nderuar.

Z. I. Celibashi: Po mënyrë tjetër shkresore, ose me email keni tentuar për të...

Përfaqësuesi i Ministrisë Shëndetësisë: Në rastin konkret nuk është tentuar një komunikimin i tillë, duhet të mirëkuptohen situatat meqënëse dhe legjislacioni është i ri dhe në rastin konkret, të paktën, nuk është arritur të bëhet një mjet alternativ, për shembull si u bë në rastin e mëparshëm një email, mbase është vlerësuar gabim ajo situata, por duke qenë dhe rasti i tillë. Gjithsesi jemi përpara situatës që nëse do ta konsiderojmë, vlerësojmë që jemi përpara situatatës që edhe nëse nuk është siç vërtetohet, që nuk është raportuar dhe ka qenë faqe, që ka qenë mirmbajtje para 3 ditësh siç ishte dhe afati i raportimit është e rëndësishme të thuhet se nuk është aktivitet i ndaluar mbi të gjitha dhe nuk është se ka ardhur ndonjë pasojë ose problematikë nëse do ta marrim të mirëqenë mosraportimin. Thjesht kërkoj që të merret në konsideratë nga Komisioneri, dhe të zbatohet në frymën e legjislacionit që nuk është penalizim i subjekteve të administratës, por të jetë mbi të gjitha edhe këshillim dhe mënyra sa më e drejtë e...

Z. I. Celibashi: Qartë, qartë, patjeter askush nuk ka qëllim që të penalizojë dhe për më tepër pa bazë ligjore, por edhe në thelb, nuk është qëllimi i penalizimit dhe sanksionimit ndaj personave fizikë ose juridikë. Natyrisht që qëllimi është që të gjithë të edukohen me respektimin e ligjit, dhe kjo nuk diskutohet që qëndron kështu.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Gjithsesi, ne do të vlerësojmë edhe pretendimet tuaja, në raport me çfarë është denoncuar dhe në ditët në vijim do të vendosim në lidhje me sa u shqyrtua për këtë çështje. Nëse do të kemi nevojë për shpjegime të tjera do të t'ju kërkojmë, që jeni të lutur që t'i dërgoni pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Po, vazhdojmë!

Znj. M. Koja: Pjesë e vlerësimit të raportimeve dhe të denoncimeve është një denoncim me numër ID 397, që ka të bëjë me subjektet zgjedhore, dhe do ta relatojë kolegja.

Z. I. Celibashi: Po, Valbona!

Znj. V. Ballgjini: Atëherë, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në dt. 5 maj 2023, është regjistruar denoncimi me numër ID 397, denoncuesi është zoti Ivi Kaso. Në denoncimin e tij zoti Ivi Kaso pretendon se në bashkinë Dibër janë vendosur postera të kandidatit të Partisë Socialiste, njëkohësisht dhe kryetari i bashkisë, jashtë vendeve të përcaktuara për afishimet elektorale. Në këtë denoncim zoti Kaso e ka shoqëruar bashkë me një video shoqëruese, në të cilën pjesë e denoncimit është dhe Bashkia Dibër, automjeti i Bashkisë Dibër, po përdoret për vendosjen e posterave të kandidatit të PS-së, njëkohësisht dhe kryetar i bashkisë. Kemi vëzhguar pamjet filmike të videos që kemi në dispozicion, autmjeti nuk përmban logo të bashkisë dhe është një automjet, i cili vendos një poster në një banesë, në një godinë banimi. Nga çfarë është vënë re në video, ne e kemi të pamundur të verifikojmë targën e automjetit në mënyrë të tillë për të verifikuar nëse ky automjet është automjeti i bashkisë apo jo. Për sa i takon materialit propagandistik, i cili është vendosur, në vijim të procedurës administrative kemi njoftuar monitoruesin e bashkisë Dibër për të kqyryr dhe për të bërë verifikimet e mundshme, nga sa raportuar nga monitoruesi

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

rezulton se afishimi i materialit propagandistik është vënë në një distancë brenda 5 metrave nga zyra kryesore e Partisë Socialiste. Por ky material propagandistik nuk përmban shënimin “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore ” dhe më pas të vijojë emri i subjektit zgjedhor. Për sa më sipër, referuar edhe vendimit numër 424, që është urdhëruar Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit për të hequr të gjitha materialet propagandistike që nuk përmbajnë këtë shënim, propozojmë që ky material propagandistik është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 79.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë në këtë situatë do të urdhërojmë heqjen e këtij materiali propagandistik.

Vandimi nr. 487

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 404, nga zoti Ivi Kaso për hapjen e zyrave zgjedhore në një distancë jo më të madhe se 300 m nga qendrat e votimit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:** Z. Ilirjan Celibashi
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
Znj. V. Ballgjini
- **Parti Politike:** s’ka
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Po vazhdojmë me denoncimet e tjera.

Znj. V. Ballgjini: Denoncimi numër 404 ID nga zoti Ivi Kaso, për hapjen e zyrave zgjedhore në një distancë jo më të madhe se 300 m nga qendrat e votimit të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Bëhet fjalë për zyrë zgjedhore të Partisë Socialiste, 40 metra nga vendndodhja e qendrës së votimit shkolla e mesme “Dhimitër Mino”, në Bubullimë të Lushnjes. Zyrë zgjedhore e Partisë Socialiste 99 metra nga dy qendrat e votimit 2919 dhe 2924, përkatësisht, shkolla 9-vjeçare dhe ajo e mesme në Krutje. Zyrë zgjedhore e Partisë Socialiste dhe qendra votimi numër 2826, që ndodhet në një distancë shumë të afërt në Golem të Lushnjes. Zyrë zgjedhore e Partisë Socialiste, e cila ndodhet vetëm 50 m distancë nga qendra e

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

votimit, shkolla “Avni Rustemi”, Tiranë. Pala kërkuese kërkon marrjen e masave të menjëhershme, përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për këtë qëllim. Doja të theksoja që lidhur me njësinë administrative Golem, Lushnjë është raportuar edhe nga monitoruesi, caktuar, për bashkinë Lushnjë në raportin e datës 9 maj, është pjesë e raportimit përmbledhës për këtë periudhë, i cili ka konstatuar që zyra zgjedhore në këtë njësi administrative është edhe qendër votimi. Në vijim të procedurave administrative u është kërkuar informacion monitoruesve të caktuar në bashkinë Lushnjë dhe Tiranë, informacion në lidhje me zyrat të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Nga informacioni që monitoruesi ka sjellë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezulton se zyrat zgjedhore janë në një në një distance shumë të afërt me qendrat e votimit. Sot pas verifikimeve të monitoruesit, sot monitoruesi i Lushnjes ka sjellë raportin ku konstaton që zyra zgjedhore, e cila njëkohësisht, ishte dhe qendër votimi është e mbyllur si zyrë zgjedhore dhe funksionon vetëm si qendër votimi. Gjithashtu konstatohet që pjesa tjetër e këtyre zyrave, jemi akoma në pritje të një raporti tjetër të monitoruesit nëse janë apo jo...

Z. I. Celibashi: Po, dakord.

Vendim nr. 494

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 405, nga zoti Ivi Kaso për ndalimin e publikimit të sondazheve zgjedhore gjate 5 (pesë) ditëve para datës së zgjedhjes nga OSHMA-të”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan Celibashi**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike: s’ka**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë...

Znj. V. Ballgjini: Shqyrtimi administrativ të denoncimit 405 ID të zotit Ivi Kaso për ndalimin e publikimit të sondazheve zgjedhore nga një OSHMA televizive përkatësisht, Report TV në datën 9 maj 2023, ora 21:00. Ka organizuar publikimin e sondazheve sipas institucionit italian “Piepoli” dhe rezultatet zgjedhore të datës 14 maj, për gjashtë bashki: Tiranën, Durrësin, Elbasanin, Shkodrën, Lezhën dhe Korçën. Pala kërkuese kërkon marrjen e masave të menjëhershme, përfshirë sanksione që parashikojnë dispozitat ligjore për këtë qëllim, lidhur me veprimet e subjektit juridik MTSC, për qëllim ndalimin e këtyre veprimtarive antiligjore dhe respektimin e rregullave. Në vijim të procedurës administrative Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i ka dërguar nëpërmjet email-it televizionit Report TV, të na kthejë

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

një përgjigje lidhur me çfarë është konstatuar nga zoti Ivi Kaso, dhe për momentin jemi ende në pritje të përgjigjes të televizionit Report TV.

Z. I. Celibashi: Mendoj që këtë pikë ta bashkojmë si shqyrtim administrativ bashkë me pikën 2 të shtesës së rendit të ditës me denoncimin e organizatës KRIIK, për publikimin e sondazheve nga televizioni Klan dhe televizioni Report TV, të jenë në një çështje dhe...

Znj. V. Ballgjini: Dakord!

Vendim nr. 485

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

11.05.2023

Ora 13:21

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimin të regjistruar me numër 407 ID, i ardhur nga organizata Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara KRIIK, për publikimin e sondazheve zgjedhore në datën 9 maj 2023, respektivisht nga 2 OSHMA: Report TV dhe Klan TV.”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:** Z. Ilirjan Celibashi
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
Znj. V. Ballgjini
- **Parti Politike:** s’ka
- **Të tjerë:** KRIIK

Znj. V. Ballgjini: Ta referojmë në një çështje, dakord. Në denoncimin të regjistruar me numër ID në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve numër 407, i ardhur nga organizata Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara KRIIK, për publikimin e sondazheve zgjedhore në datën 9 maj 2023, respektivisht nga 2 OSHMA: Report TV dhe Klan TV. Të cilat kanë transmetuar sondazhe në datën 9 maj, në orën 21, Report TV, dhe Klan TV, përgjatë emisionit “Opinion”. Sikurse u referua edhe më parë lidhur me denoncimin e zoti Ivi Kaso, i’u është kërkuar të dyja televizioneve të na kthejnë një përgjigje lidhur me çfarë është konstatuar nga organizata KRIIK dhe zoti Ivi Kaso, dhe jemi në pritje të përgjigjes të dy televizioneve.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Z. I. Celibashi: Pra, u është dërguar të dyja televizioneve kërkesa për të dhënë shpjegim dhe informacion për sa pretendojnë. Dakord. Po vazhdojmë me...

Znj. V. Ballgjini: Po të dyja.

Z. I. Celibashi: Këto do të jenë në një çështje dhe vendimmarrja do të jetë në referim të kësaj çështjeje, në vlerësimin përfundimtar të kësaj çështjeje, të bashkuara.

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 406ID, nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për afishimin e materialeve propagandistike te Koalicionit “Bashkë Fitojmë” në Bashkinë Himarë”.

PJESËMARRJA :

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
- Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
Znj. V. Ballgjini**
- Parti Politike: **s’ka**
- Të tjerë: **KRIIK**

Znj. V. Ballgjini: Në datën 10 maj 2023, Partia Socialiste e Shqipërisë ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, një denoncim, i cili është regjistruar me numër ID 406. Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë pretendon se në njësinë administrative Lukovë, në datën 5 maj 2023, si dhe në njësinë administrative Himarë në datën 5 maj 2023, janë vendosur banera me përmasa afërsisht 6 me 2 metra, nga koalicioni “Bashkë fitojmë”, në fasada banimi, dhe nuk përmbajnë shënimin “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore” dhe më pas të vijojë emri i subjektit, i cili i vendos këto.

Z. I. Celibashi: Denoncimi është nga Partia Socialiste ?

Znj. V. Ballgjini: Po, ky denoncim është nga Partia Socialiste.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Z. I. Celibashi: Mirë t'ju kërkojmë shpjegime koalicionit “Bashkë Fitojmë” në lidhje me vendosjen e këtyre banderolave.

Vendim nr. 495

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 deri 10 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan Celibashi**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike: s’ka**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Dakord, vazhdojmë!

Znj. V. Ballgjini: Pika tjetër e rendit të ditës është përmbledhje e raportimeve, shqyrtimeve dhe raportimeve të monitoruesve për periudhën 9-10 maj 2023. Për këtë periudhë janë përcjellë 45 raporte monitorimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga monitoruesit e fushatës zgjedhore. Nga vlerësimi i bërë gjetjeve, në këto raporte rezulton se 4 prej tyre pasqyrojnë shkelje të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit numër 6. Shkeljet e raportuara nga monitoruesit janë vetëm lidhur me zyrat zgjedhore, të hapura nga subjektet zgjedhore, në një distancë jo më të vogël se 300 m nga vendndodhjet e KZAZ-ve dhe QV- dhe BNV-ve. Përkatësisht janë 3 zyra zgjedhore nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste, për Bashkinë Fier, 80 m nga shkolla “Liri Gero”, për Bashkinë Fier, po prapë, 140 m nga shkolla “Perikli Ikonomi”, pra këto janë edhe qendra votimi, dhe në njësinë administrative Golem, bashkia Lushnjë, është edhe ajo se çfarë edhe zoti Kaso ka denoncuar, zyrë zgjedhore e hapur, është

***Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

edhe qendër votimi. Dhe një raportim për subjektin zgjedhor “Lëvizja Bashkë”, në Bashkinë Tiranë, është hapur një zyrë zgjedhore, e cila është 20 m nga shkolla “Avni Mula”, e cila është edhe qendër votimi.

Z. I. Celibashi: Po, të gjitha këto zyrat zgjedhore, të cilat janë në këtë distancën që e ndalon ligji për... në lidhje me ambientet e votimit, do të urdhërojmë mbylljen e tyre. Do t’i kërkojmë subjekteve që t’i mbyllin, përndryshe policia bashkiake do të ndërhyjë forcërisht.

Vendimi nr. 496

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

11.05.2023
Ora 13:25

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 364 ID, të Koalicionit Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj Kryetarit të Bashkisë Kamëz”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:** Z. Ilirjan Celibashi
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
Znj. V. Ballgjini
- **Parti Politike:** s’ka
- **Të tjerë:** KRIIK

Znj. V. Ballgjini: Të referoj pikën jashtë rendit të ditës, tjetrën, apo të vazhdoj?

Z. I. Celibashi: Përfundojmë me këto çështjet që kemi në rendin e ditës, pastaj kemi shpalljet e vendimeve.

Z. M. Koja: Në rendin e ditës kemi shpalljen e vendimeve. Shpallja e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 364 ID, të koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, KRIIK, ndaj Kryetarit të Bashkisë Kamëz”. Objekt denoncimi është Bashkia Kamëz, ka vijuar me postime elektorale të Partisë Socialiste dhe të kandidatit për kryetar të Bashkisë Kamëz, aktualisht kryetar i saj. Ne kemi kërkuar informacion nga Bashkia Kamëz, por nuk i është përgjigjur kërkesës tonë. Ne kemi vijuar me gjykimin e rastit, në bazë të

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

provave të administruara nëpër rrjetin social facebook, postuar në faqen e Bashkisë Kamëz. Lidhur me këtë objekt shqyrtimi, sa i përket postimeve në faqen zyrtare të bashkisë Kamëz, referuar linqeve që na janë vënë në dispozicion dhe kemi administruar, nga verifikimi në fazën e administrimit dhe me pas të shqyrtimit të denoncimit, rezulton se postimet me këtë objekt denoncimi, nuk gjenden në faqen zyrtare, dhe për këtë arsye, nuk arrijmë të provojmë dot shkeljen administrative të pretenduar, dhe propozojmë pushimin e këtij procedimi administrativ.

Z. I. Celibashi: Nuk janë? Nuk janë më, ndoshta.

Z. M. Koja: Në momentin që i kemi administruar ne nuk i kemi gjetur. Pra janë klikuar linqet e vëna në dispozicion, dhe verifikime të mëtejshme që kemi bërë, nuk janë postimet, ripostimet më saktë.

Z. I. Celibashi: Atëherë do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ.

Vendim nr. 491

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

**11.05.2023
Ora 13:27**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 365 ID, të Koalicionit Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj Agjencisë për Media dhe Informim”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:** **Z. Ilirjan Celibashi**
- **Stafi KQZ:** **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **s’ka**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Po vazhdojmë me..

Z. M. Koja: Shpallja e vendimit në lidhje me denoncimin 365 ndaj Agjencisë për Median dhe Informim për postim dhe ripostim me përmbajtje elektorale në faqen zyrtare të këtij institucioni. Denoncues është KRIIK, objekti i denoncimit, ka të bëjë pikërisht me ripostimin dhe postimin e veprimtarive me karakter publik në faqen zyrtare të këtij institucioni. Nga ana e Agjencisë për Media dhe Informim, kemi marrë këto sqarime: “Aktiviteti elektoral i datës 12 prill 2023, shoqëruar me slogane politike të Partisë Socialiste, është postuar në faqen e MIA-s, në rrjetin social facebook dhe si rrjedhojë e një gabimi sa teknik, po aq edhe njerëzor, nga ana e personit përgjegjës pranë kësaj agjencie. Menjëherë pas evidentimit të këtij gabimi, janë marrë masat për heqjen e videos nga faqja zyrtare”. Personi që ka sjellë prapësimet, në cilësinë e zëvendës drejtorit të përgjithshëm, është shprehur se “në

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

mënyrë të menjëhershme ka tërhequr vëmendjen e drejtuesve, dhe drejtorive pranë MIA-s, për të qenë të kujdesshëm, për të respektuar Kodin Zgjedhor”. Nga verifikimi që ne kemi kryer në fazën e administrimit, denoncimit, dhe më pas të shqyrtimit, rezulton se postimi për të cilin është bërë denoncimi nuk gjendet më, në faqen zyrtare, sikundër edhe institucioni e pranon nga ana e tij, ai është i publikuar, dhe më pas është fshirë. Në këto kushte, ne sugjerojmë pushimin e procedimit administrativ edhe për këtë rast.

Z. I. Celibashi: Pra, edhe vetë përfaqësuesi i institucionit e pranojnë atë se çfarë është denoncuar nga organizata KRIIK, dhe jemi njësoj si rasti i bashkisë së Durrësit, që nuk gjendet më që prej asaj dite, në këto postime, dhe nuk ka më postime të tjera të karakterit politik, elektorale.

Znj. M. Koja: Jo, në momentin që ne kemi në shqyrtim, jo nuk ka.

Z. I. Celibashi: Mirë, është e rëndësishme që kanë reflektuar deri kur kanë kuptuar që është e ndaluar në raport me Kodin Zgjedhor, ajo çfarë kanë bërë me përpara dhe nuk është rasti për të vendosur sanksion administrativ dhe do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ edhe për këtë rast.

Vendim nr. 489

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 366 ID, të Koalicionit Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj Kryetarëve të Bashkive”.


PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan Celibashi**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike: s’ka**
- **Të tjerë: KRIIK**

Znj. M. Koja: Denoncimi i KRIIK me nr. 366 ID, ndaj bashkive: Kamëz, Poliçan dhe Vlorë, “Për postim dhe ripostim me përmbajtje elektorale në faqen zyrtare të këtyre institucioneve”. Në përfundim të shqyrtimit, rezulton se për bashkitë Kamëz dhe Vorë ka rispostime dhe publikime me përmbajtje hashtag dhe slogane me karakter politik, elektorale, çka në bindjen tonë përbën keqpërdorim të llogarisë funksionale të institucionit publik, dhe për pasojë, vlerësojmë, se jemi përpara një shkelje administrative dhe propozojmë sanksion administrativ ndaj kryetarëve të bashkive Kamëz dhe Vorë.

Z. I. Celibashi: Po, dakord, atëherë, do të vendoset sanksion administrativ ndaj drejtuesve të këtyre dy bashkive, sipas denoncimit të bërë nga KRIIK.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Znj. M. Koja: Ndërsa për bashkinë Poliçan që është subjekt denoncimi, nga verifikimi paraprak në rrjetin social facebook të bashkisë Poliçan, në fazën e administrim-denoncimit, rezulton që ripostimi objekt denoncimi nuk gjendet më në faqen zyrtare të kësaj bashkie. Si dhe për rastet e mëparshme propozojmë që të pushohet procedimi administrativ për bashkinë Poliçan.

Z. I. Celibashi: Do të thotë që ka qenë, por e kanë fshirë, edhe në këtë rast do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ, sikurse arsyetuar për të mospërsëritur, shkurt, që nuk është qëllimi për të sanksionuar por e rëndësishme të kuptojnë ku janë limitet, kufiri ndërmjet veprimtarisë publike dhe veprimtarisë politike dhe elektorale dhe sa kohë që është kuptuar, është pa sens, vendosja e një sanksioni administrativ. Po, do të vendosim në këtë rast pushimin e shqyrtimit administrativ.

Vendim nr. 498

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 367 ID, të Koalicionit Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj Kryetarëve të Bashkive”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan Celibashi**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike: s’ka**
- **Të tjerë: KRIIK**

Znj. M. Koja: Shpallje vendimi për denoncimin nr. 367 ID, i bërë nga KRIIK kundër kryetarëve të disa bashkive, konkretisht janë kryetarët e bashkive: Mat, Përmet, Krujë, Belsh, Berat, Cërrik, Delvinë, Devoll, Dibër, Divjakë, Dropull, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Vorë, Rrogozhinë, Shijak, Kolonjë, Tiranë dhe Skrapar edhe Lushnjë, ndjesë. Objekt denoncimi është postimi në faqen personale të këtyre kryetarëve të bashkive gjatë hapjes të fushatës zgjedhore të Partisë Socialiste në datën 11 prill 2023. KRIIK ka vërejtur që sloganet e fushatës “Vetëm përpara, kurrë më mbrapa”, shoqërojnë thuajse çdo postim të bërë në faqet personale të kryetarëve të bashkive. Në rrjetin social facebook, ata bëjnë ripostime të faqeve të ministrave, të Kryeministrit, etj... Sipas KRIIK, kjo përbën keqpërdorim të burimeve, ndaj duhet marrë sanksioni përkatës nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Sugjerojmë që postimet në llogarinë personale në facebook, të kryetarëve të bashkive nuk konsiderohen, si keqpërdorim i burimeve publike. Ato janë faqe personale të tyre,

**Zbardhi materialin audio
Jonë DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

kanë një marrëdhënie personale me postimet në llogaritë përkatëse të tyre, dhe i përdorin ato për të bërë dhe fushatën zgjedhore, në të cilat marrin pjesë. Kështu që në këto kushte sugjerojmë, të pushohet shqyrtimi administrativ për kryetarët e bashkive, për këtë rast denoncimi.

Z. I. Celibashi: Dakord, ne e kemi mbajtur që në krye të herës këtë qëndrim, që këto llogari i kemi konsideruar si llogari të tyre personale, dhe postimet e bëra në këto llogari nuk janë, sikurse janë postimet që bëhen në llogaritë apo në profilet e institucioneve publike.

Vendim nr. 499

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

**11.05.2023
Ora 13:34**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 368 ID, të Koalicionit Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj Ministrave dhe personave përgjegjës në Ministri”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan Celibashi**
- **Stafi KQZ:** **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **s’ka**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Znj. M. Koja: Shpallja e vendimit për denoncimin me numër ID 368, i bërë nga KRIIK, ndaj disa ministrave dhe Ministrive. Konkretisht janë ndaj Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë për Europën dhe Punëve të Jashtme, Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve, si dhe ndaj disa ministrave, zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, të Kulturës, të Drejtësisë, të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve, Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Objekt denoncimi është serish hapja e fushatës elektorale nga Partia Socialiste, në

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

nga Partia Socialiste, në dt. 11 prill 2023, kjo e fundit bëri publike sloganin e fushatës të zgjedhjeve të 14 Majit, “Vetëm përpara, kurrë më mbrapa”. KRIIK ka vërejtur që këto slogane shoqërojnë thuajse çdo postim pavarësisht se ato janë me natyrë institucionale në faqet zyrtare, në rrjetin social facebook të Kryeministrit, ministrave, bashkive, kryetarëve të bashkive, etj... Këto slogane të përdorura edhe si hashtag, lidhen dhe identifikohen drejtpërsëdrejti me subjektin zgjedhor Partia Socialiste. Në përfundim të vlerësimit dhe të verifikimit, të sa prezantohet nga denoncuesi, konkludojmë si vijon: Për sa i përket ministrive, konkretisht, institucionet publike, si Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministri i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, kanë bërë një sërë publikimesh apo ripostimesh me përmbajtje hashtag dhe slogane me karakter politik, elektoral. Në vlerësimin tonë kjo bën keqpërdorim të llogarive institucionale të ministrive dhe për pasojë vlerësohet se jemi përpara shkeljes administrative për këto institucione dhe propozojmë marrjen e sanksioneve dhe urdhërimin për heqjen e hashtagëve dhe ripostimeve me përmbajtje politike.

Z. I. Celibashi: Për këto raste do të vendosim sanksione administrative, si dhe të urdhërojmë fshirjet nga profilet dhe nga faqet e internetit të këtyre ministrive, të gjitha mesazheve politike dhe elektorale.

Znj. M. Koja: Për sa i përket Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nga verifikim paraprak në fazën e administrimit, denoncimit dhe shqyrtimit, rezulton që nuk kanë postime me përmbajtje elektorale sikurse pretendohet dhe për këtë ministri, ne sugjerojmë të pushohet procedimi administrativ.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Z. I. Celibashi: Po, dakord, do të pushojmë procedimin administrativ.

Znj. M. Koja: Ndërsa për sa i përket postimeve me përmbajtje politike të ministrave i qëndrojmë edhe qëndrimin që kemi mbajtur edhe më lart kjo nuk përbën... dhe të pushohet dhe të pushohen procedimi administrativ për këto të denoncuar.

Z. I. Celibashi: Po, dakord.

Znj. M. Koja: Ndërkohë për efekt të informimit më duhet të sjellë në vëmendje çfarë është relatuar në seancën publike të ditës së djeshme, dhe të konstatoj se është bërë një lapsus në momentin që kam relatuar për sa i përket denoncimit me numër 348 të bërë nga KRIIK, subjekt i denoncuar Bashkia Tiranë, objekt denoncimi kryetari i Bashkisë Tiranë, ka përdorur mbledhjen e radhës të këshillit bashkiak të datës 19 prill dhe pozicionin e tij zyrtar si kryebashkiak, për të bërë fushatë elektorale në favor të tij dhe subjektit elektorale që përfaqëson. Në raportim jemi shprehur që nuk kemi administruar video e këtij takimi, në të vërtetë, video është administruar dhe është dhe e transkriptuar nga KRIIK, kjo ka ardhur për shkak të ngarkesës shumë të madhe, jemi mbi katërqind e ca denoncime, dhe për këtë kërkoj dhe ndjesë personalisht. Ne jemi në fazën, duke kërkuar shpjegime Bashkisë Tiranë, dhe ju kërkoj ju, Komisioner, që të vijojmë me hetimin, dhe vendimmarrja të jetë në një moment të dytë për këtë rast denoncimi.

Z. I. Celibashi: Po dakord, t'i kërkojmë informacion dhe shpjegime Bashkisë Tiranë, në lidhje me këtë çështje, dhe mandej të vazhdojmë me procedimin administrativ. Dakord,

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Znj. M. Koja: Faleminderit.

Vendim nr. 490

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për autorizimin për ndryshimin e vendndodhjes të disa qendrave të votimit”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan Celibashi**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike: s’ka**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Çështje të tjera kemi? Projektvendimi për autorizimin për ndryshimin e vendndodhjes të disa qendrave të votimit.

Z. Y. Merkaj: Sipas përcaktimit të nenit 62, pika e parë, paragrafi 4, i Kodit Zgjedhor, “Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga Komisioni Zgjedhor i Zgjedhjeve”. Në KQZ, është administruar propozimi i kryetarit të bashkisë Belsh, duke iu referuar si më poshtë: se dy qendra votimi, konkretisht qendra votimi nr 2553/00 dhe qendra e votimit nr 2553/01 është bërë një ngatërresë ku zgjedhësit e një qendre votimi me vendndodhje, me ambient privat të zotit Ylli Tafani, janë regjistruar në qendrën e votimit tjetër dhe anasjelltas, duke iu referuar gjithashtu edhe njoftimit i zgjedhësve është bërë shtëpi me shtëpi, duke pasur parasysh qendrën e votimit, jo atë që është shënuar, por atë që ka qenë në zgjedhjet e kaluara, propozohet që të

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

ndryshojë vendndodhja e këtyre dy qendrave të votimit. Qendrat e votimit janë në një territor të fshatit Gradisht, distanca midis tyre është 600 m largësi linear. Gjithashtu nga KQZ-ja është administruar edhe një rast i KZAZ-së nr. 28 dhe propozimi i kryetarit të bashkisë Kamëz për ndryshimin e vendosjes së qendrave të votimit nr.1578/00, 1578/01, 1578/02, 1578/03, dhe 1578/04, të cilat janë miratuar në pallatin e kulturës “Artan Çuku” dhe kërkohet ndryshimi i tyre në një ambient privat shkolla jopublike “Elina”, kjo për shkak sepse nuk plotëson kushtet për qendrat e votimit në pallatin e kulturës “Artan Cuku”. Për sa më sipër i propozojmë Komisionerit, dhënie autorizimi për ndryshimin e qendrave të votimit të Bashkisë Belsh dhe Bashkisë Kamëz.

Z. I. Celibashi: Kjo situata e Belshit është e qartë, po kjo e Kamzës, kemi bërë komunikime dhe me përfaqësues të partive dhe KZAZ-ja?

Z. Y. Merkaj: Po janë njoftuar, janë njoftuar në këtë...

Z. I. Celibashi: Dhe nuk ka asnjë mundësi që të zhvillohet votimi atje ku vetë kryetari i bashkisë e ka caktuar atje.

Z. Y. Merkaj: E ka caktuar kur ka qenë ambienti i hapur dhe që nuk e kishte parashikuar që të ishin 5 qendra votimi në një ambient të madh domethënë në një holl të madh.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Z. I. Celibashi: Por në zgjedhjet e shkuara kur ka qenë në Kamëz, në cilat... se jemi vetëm 2 ditë para votimit, 3 ditë. Bëni një verifikim edhe për këtë.

Vendim nr. 488

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

11.05.2023
Ora 13:43

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 408 ID, i regjistruar në datën 10 maj 2023 nga zoti Ivi Kaso, ndaj subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:** Z. Ilirjan Celibashi
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
Znj. V. Ballgjini
- **Parti Politike:** s’ka
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Kemi çështje të tjera? Po, e fundit nëse nuk gaboj.

Znj. V. Ballgjini: Denoncimin me numër ID 408, i regjistruar në datën 10 maj 2023 nga zoti Ivi Kaso, i cili pretendon se subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë ka hapur në një distance shume afër me vendndodhjen e KZAZ-nr 29, shkolla 9-vjeçare “Katund i Ri”. Bëhet fjalë për bashkinë Tiranë në Kashar, pra kjo shkollë ndodhet në Kashar. Menjëherë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vijim të procedurës administrative njoftoi monitoruesin e caktuar për këtë zonë dhe nga raporti i monitorimit që është sjellë sot nga monitoruesi raporton se kjo zyrë zgjedhore është 10 metra nga KZAZ-ja numër 29, Kashar, bashkia Tiranë. Pra rezulton që është zyrë zgjedhore hapur.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.11.05.2023*

Z. I. Celibashi: Mire atëherë do të urdhërojmë mbylljen e kësaj zyre zgjedhore, të komunikojmë me subjektin për ta mbyllur vullnetarisht këtë zyrë zgjedhore, përndryshe do të mbyllet duke urdhëruar policinë bashkiake Tiranë për të bërë mbylljen e kësaj zyre zgjedhore. Çështje të tjera? Nuk kemi. Mirë, faleminderit, seanca mbyllet.

Vendim nr. 497

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

